



Pranuar / Dorezuar Prilijeno / Prodato Received / Delivery	06.11.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
S.KRINSHICK	6889/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 1195/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1195/2023 të datës 22.09.2023 të parashtruar nga ankuesi banimi: _____, kundër Vendimit me numër të

referencës Ref. 03/Nr.01 të datës 19.09.2023 të Udhëheqëse se Njësies së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "Transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 06.11.2023, mori këtë

V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.1195/2023 e datës 22.09.2023 e parashtruar nga ankuesi _____

II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me numër reference Ref. 03/Nr.01 i datës 19.09.2023 i Udhëheqëses së Njësies së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

III. **OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të bëjë zbatimin e këtij Vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, duke e kthyer ankuesin në pozitën "Drejtor i Drejtoratit për Çështje Administrative të Regjistrimit të Biznesit" në ARBK sipas Akt Emërimit të datës 07.05.2015 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij të punës.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy et im

Ankuesi [redacted] i punësuar në pozitën e punës "Drejtor i Drejtoratit për Çështje Administrative të Regjistrimit të Biznesit" në ARBK në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (tani e tuje referuar si MINT), me datë 19.09.2023 me Vendimin me numër reference Ref.03/Nr.01 të Udhëheqëses së Njësisë së Burimeve Njerëzore është transferuar për periudhë gjashtë (6) mujore në pozitën "Drejtor i Drejtoratit për Standarde, Promovim dhe Integrim" në Agjencinë Kosovare për Standardizim, në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Kundër Vendimit me numër reference Ref.03/Nr.01 të Udhëheqëses së Njësisë së Burimeve Njerëzore së Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ankuesi me datë 22.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6198/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.1195/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se vendimi i atakuar është i kundërligjshëm për shkak të mohimit të drejtave elementare të punës, mohimit të njoftimit paraprak si dhe shkeljeve të përcaktuara ligjore në rastet e transferimit të përkohshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave, me datë 04.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Ndërsa me datë 10.10.2023, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 6181/2023 të datës 22.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 683/03 të datës 19.09.2023; Emalin e datës 18.09.2023 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 18.09.2023 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 16.09.2023 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 15.09.2023 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 15.09.2023 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 14.09.2023 të [redacted] Drejtuar [redacted] Emalin e datës [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 28.08.2023 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 13.07.2023 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 26.07.2023 të [redacted] drejtuar [redacted]; Emalin e datës 25.07.2023 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 25.07.2023 të [redacted] drejtuar [redacted] Emalin e datës 21.07.2023 të [redacted] drejtuar [redacted] Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 04.10.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 10.10.2023; Ndryshim dhe plotësimin e aktit të emërimit të datës 07.05.2015; Përshkrimin e detyrave të punës lidhur me pozitën e punës "Drejtor i Drejtoratit për Çështje Administrative të Regjistrimit të Bizneseve" të datës 07.5.2015; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e punës "Drejtor i Drejtoratit për Standarde, Promovime dhe Integrim" të datës 24.03.2017; Emalin e datës 18.09.2023 të [redacted] drejtuar [redacted].

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha provat bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe konstatuar që ankesa e ankuesit është e bazuar sepse:



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i provave të bashkangjitura në shkresat e lëndës, ka gjetur se ankuesi sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 07.05.2015 është i punësuar në pozitën e punës "Drejtor i Drejtoratit për Çështje Administrative të Regjistrimit të Bizneseve" në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë/MINT. Më tej, nga provat e lëndës rezulton se me Vendimin me numër të referencës Ref.03/Nr.01 të datës 19.09.2023 të Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndermarrësisë dhe Tregtisë, ankuesi është transferuar për periudhë gjashtë (6) muaj në pozitën "Drejtor i Drejtoratit për Standarde, Promovim Dhe Integrim" në Agjencinë Kosovare për Standardizim, në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Ankuesi në ankesën e tij të parashtruar me datë 22.09.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, pretendon së organi i punësimit me rastin e transferimit të tij ka vendosur në mënyrë të gabuar dhe jo të drejt duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë si dhe ligjeve tjera relevante.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 2 paragrafin 2.1 ku përcaktohet se: *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve. Transferimi mund të bëhet: 2.1. brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale, dhe nenit 5 paragrafit 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ku është përcaktuar se: "Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kriterëve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet", dhe rrjedhimisht Kolegji vlerëson se organi i punësimit ka të drejtë që nëpunësin civil ta transferojë përkohësisht për interes të institucionit, mirëpo në kuptim të nenit 52 paragrafi 7 të të njëjtit ligj, si dhe nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, Kolegji konstaton se transferimi i përkohshëm në interes të institucionit është në kompetencë të njesisë përgjegjëse të Burimeve Njerëzore. Sipas dispozitave të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, njësi përgjegjëse në Ministrinë e Industrisë, Ndermarrësisë dhe Tregtisë është Njësia për Burime Njerëzore, dhe se e njëjta respektivisht Njësia e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse në rastet e tilla njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet, dhe se për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kriterëve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet. Andaj mbi këtë bazë si dhe duke u bazuar nga dëshmitë e ofruara të bashkangjitura në shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore nuk ka arritur të dëshmojë me asnjë dëshmi të vetme se ka hartuar ndonjë analizë lidhur me plotësimin e kriterëve të pozitës të punës nga ana e ankuesit ku ai kërkohet të transferohet gjegjësisht e njëjta Vendimin lidhur me transferimin e ankuesit nuk e ka mbështetur në analizën lidhur me plotësimin e kriterëve të pozitës të punës nga ana e ankuesit si dhe po ashtu nuk e ka njoftuar*

ankuesin me shkrim lidhur me transferimin ashtu siç përcaktohet me dispozitën ligjore të lartcekur.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se vendimi për transferimin e ankuesit nga pozita e punës *"Drejtor i Drejtoratit për Çështje Administrative të Regjistrimit të Bizneseve"* në ARBK, në pozitën e punës *"Drejtor i Drejtoratit për Standarde, Promovim dhe Integrim"* në Agjencinë Kosovare për Standardizim, është bazuar vetëm në emalin e datës 18.09.2023 të Zyrtares së Larte Ekzekutive të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm dërguar Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore, ku ka theksuar se **citoh** „ E nderuar me kërkesë të Zv. Sekretarit të Përgjithshëm z. _____ *ju lutemi hartoni draft vendimin për caktimin e z.*

në pozitën Zv. Drejtor i Drejtoratit për Standarde, Promovim dhe Integrim për periudhë 6 (gjashtë) mujore". Rrjedhimisht sipas shkresave të lëndës të përcjellura nga organi i punësimit Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore nuk ka arritur të sqarojë mjaftueshëm situatën faktike mbi bazën e së cilës është marrë vendimi i atakuar përmes kësaj ankese, respektivisht nuk ka arritur të sqarojë në mënyrë të hollësishme se për çfarë arsye apo cili është interesi i institucionit lidhur me transferimin e ankuesit .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjithashtu ka shqyrtuar edhe pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Vendimi me numër reference Ref. 03/Nr.01 të datës 19.09.2023 i Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore së Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë lidhur me transferimin e ankuesit nga pozita *"Drejtor i Drejtoratit për Çështje Administrative të Regjistrimit të Biznesit"* në ARBK, në pozitën *Drejtor Drejtoratit për Standarde, Promovim dhe Integrim"* në Agjencinë Kosovare për Standardizim është në kundërshtim edhe me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative sepse nuk përmban elementet substanciale të aktit administrativ, andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore së Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Vendimin e atakuar e ka arsyetuar vetëm me këto fjalë **citoh** : *Me kërkesë të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndermarrësisë dhe Tregtisë si dhe me pajtim me Zëvendësuesen e Drejtores së Përgjithshëm të ARBK-së se në interes të institucionit MINT, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi"*, andaj Kolegji vlerëson se Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore së Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, nuk ka arritur të arsyetojë vendimin siç përcaktohet me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: ku ceket se *"Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave si dhe 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret"*, po ashtu nuk ka arritur të sqarojë mjaftueshëm situatën faktike mbi bazën e së cilës është marrë vendimi i atakuar përmes kësaj ankese, respektivisht nuk ka arritur të sqarojë në mënyrë të hollësishme se për çfarë arsye apo cili është interesi i institucionit lidhur me transferimin e ankuesit, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se mungesa e arsyetimit të pamjaftueshëm të Vendimit me numër reference Ref. 03/Nr.01 të datës 19.09.2023 të Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore së Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, është e barabartë me mungesën e tij siç përcaktohet me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 48 paragrafi 2 i cili përcakton

se: "Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij". Kolegji për Shqyrtimin Dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Vendimi me numër reference Ref. 03/Nr.01 i datës 19.09.2023 është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1,1.2, 1.3 dhe 1.4 dhe me nenin 48 paragrafin 2 që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, sepse rrjedhimisht vendimi nuk arsyeton gjendjen faktike dhe bazën juridike siç përcaktohet me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse vendimi i lartë cekur përmban vetëm formulime të përgjithshme por mungon analiza apo arsyetimi me i detajuar mbi shpjegimin e situatës faktike dhe shkaqeve të cilat kanë qenë vendimtare mbi të cilën është marrë vendimi për transferimin e ankuesit, respektivisht nuk kemi asnjë prove me të cilën dëshmohen dhe arsyetohen shkaqet se pse ankuesi është dashur transferohet për interes të institucionit gjegjësisht cili është interesi i institucionit për transferimin e ankuesit .

Bazuar si me lartë e në vështrim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili ka përcaktuar se : „Një akt administrativ i nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ është akt administrativ i paligjshëm kështu që Këshilli me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, e duke iu bazuar në autorizimet e përcaktuar me nenin 55 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka shfuqizuar Vendimin me numër reference Ref. 03/Nr.01 të datës 19.09.2023 të nënshkruar nga Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë duke obliguar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që brenda afatit të përcaktuar si në pikën III të dispozitivit ta kthej ankuesin _____ në pozitën e punës "Drejtor i Drejtoratit për Çështje Administrative të Regjistrimit të Biznesit" në ARBK sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 07.05.2015 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.

Në rast të moszbatimit të Vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1195/2023

Ilire-Mehmeti-SHAQIRI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.